



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Trepça Shoqëri Aksionare
Trepça Deoničarsko Društvo / Trepça Joint Stock Company



Në mbështetje të nenit 3 paragrafit 1, nën-paragrafit 1.4 dhe nenit 9 paragrafit 8, nën-paragrafit 8.1 të Ligjit Nr. 05/L-120 për Trepçën, nenit 19 paragrafit 2, nën-paragrafit 2.3 dhe nenit 21 të Statutit të Trepça Sh.A, dhe vendimit me nr.prot:1104, Bordi i Përkohshëm Mbikëqyrës i Trepça Sh.A me datën 29.02.2024, shpall:

KONKURS

Pozita: Udhëheqës i njësisë biznesore Minierat me Flotacion Trepça Sh.A

Vendi i punës: *Stan Terg - Mitrovicë;*

I përgjigjet: *Bordit Mbikëqyrës të Drejtorëve, dhe Kryeshefit Ekzekutiv*

Kohëzgjatja e kontratës: *Tri (3) vite, me mundësi vazhdimi*

Paga: *Në pajtim me deklaratën për politiken e kompensimit të aprovuar nga Bordi Mbikëqyrës i Drejtorëve;*

Orari i punës: *I plotë*

1. Të përgjithshme

Kandidatët për këtë vend pune duhet të jenë persona me integritet, të cilët plotësojnë kushtet e kualifikimit, kriteret e pavarësisë, duhet të kenë përvojë të nevojshme profesionale dhe shkollimin e kërkuar.



Detyrat dhe përgjegjësit kryesore:

- Në bashkëpunim të ngushtë me Bordin Mbikëqyrës, Kryeshefin Ekzekutiv dhe zevndes Kryeshefin Ekzekutiv udhëheq zhvillimin strategjik të Njesisë biznesore;
- Propozon plane, projekte investuese për njesitë e Trepça Sh.A;
- Organizon, mbikëqyrë dhe mbanë përgjegjësi për të gjitha çështjet e biznesit të njesisë;
- Ndihmon në përgatitjen dhe mbikëqyrjen e zbatimit të planeve vjetore të biznesit të njesisë, përfshirë administrimin e buxhetit vjetor për operime, mirëmbajtje, shpenzime, paga dhe shpenzime kapitale;
- Është përgjegjës për menaxhimin e përgjithshëm të njesisë duke siguruar qëndrueshmërinë afatgjate financiare të saj;
- Siguron vendosjen e sistemeve të kontrollit të brendshëm, menaxhimit të informacionit duke i mundësuar njesisë të ekzekutoj aktivitetet e saj në mënyrë të ligjshme dhe etike;
- Raporton tek Bordin Mbikëqyrës dhe Kryeshefi Ekzekutiv i Trepça Sh.A;
- Për punën e tij i përgjigjet Kryeshefit Ekzekutiv;
- Kryen dhe punë të tjera të përcaktuara me ligjet e zbatueshme, Statutin dhe aktet tjera të brendshme të ndërmarrjes.

KUALIFIKIMI DHE PËRSHTATSHMËRIA PROFESIONALE

Një kandidat për t'u zgjedhur në pozitën e **Udhëheqësit të njesisë biznesore Minierat me Flotacion Trepça Sh.A**, duhet të plotësoj kushtet, të ketë kualifikime dhe përvojë pune si vijon:

- Kandidati duhet të ketë diplomë universitare në fushën: inxhinier i diplomuar i xehetarisë apo master, inxhinier i diplomuar i gjeologjisë, inxhinier i diplomuar i metalurgjisë, ekonomist i diplomuar, jurist i diplomuar, administrim biznesi. Preferohet edukim i avancuar (master) në sektorin relevant. Diplomat nga universitet jashtë vendit duhet të jenë të nostrifikuara.
- Kandidati duhet të ketë së paku 5 vite përvojë pune në menaxhment të lartë
- Kandidati duhet të ketë integritet të lartë personal dhe profesional për ushtrimin e pozitës të **Udhëheqësit të njesisë biznesore Minierat me Flotacion Trepça Sh.A**
- Njohuri të mira të kompjuterit dhe pakos Microsoft Office;



INFORMATË E PËRGJITHSHME PËR KANDIDATËT LIDHUR ME PROCEDURAT E KONKURIMIT

Kandidatët për pozitën e Udhëheqësit të njësisë biznesore Minierat me Flotacion Trepça Sh.A duhet të dorëzojnë këto dokumente:

1. Aplikacioni (i cili shkarkohet online nga web-faqja e Trepça Sh.A)
2. Deklarata nen betim (e cila shkarkohet nga web-faqja e Trepça Sh.A apo pranohet ne kopje fizike ne Trepça Sh.A)
3. Letër motivuese
4. CV - Biografia
5. Kopjen e ID/Pasaportës valide;
6. Kopjet e diplomave të noterizuara mbi kualifikimin arsimor dhe/ose nostrifikimin për diplomat e marra jashtë vendit
7. Dëshminë e përvojës menaxheriale nga punëdhënësi (Dëshmi edhe nga trusti pensional)
8. Certifikatën (dëshminë) nga gjykata kompetente që dëshmon se nuk është nën hetime jo më të vjetër se gjashtë (6) muaj

Çdo përgënjeshttrim i informatave, qoftë i qëllimshëm apo nga neglizhenca ose edhe ndryshim i tyre nga ato të deklaruara më lartë do të rezultojë në skualifikim të menjëhershëm

Dokumentacioni duhet të dorëzohet përmes e-mailit: hr@trepcasha.com duke cituar në “subject” titullin e pozitës që aplikon.

Kandidatet me dokumentacion të mangët, të pa plotësuar dhe jo adekuat do të refuzohen. Po ashtu, dokumentet e dorëzuara pas afatit të paraparë për mbyllje të konkursit publik nuk do të pranohet.

I gjithë dokumentacioni duhet të jetë në formë origjinale ose në kopje të noterizuar. Diplomat universitare të marra jashtë shtetit, duhet të sillen së bashku me vendimin për nostrifikim nga MASHT.

Dokumentacioni i dorëzuar nuk kthehet dhe vetëm kandidatët e përzgjedhur që i plotësojnë kushtet do të ftohen në intervistë.

Afati i konkursit është i hapur 15 ditë nga data e publikimit në web faqen e Trepça Sh.A. dhe në shtypin ditor.

Afati i fundit për aplikim: 15.03.2024

